

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës



Skenar për orë mësimi Si të parandalojmë trafikimin me fëmijë të moshës së hershme shkollore (klasa VI)

Autor: Dr. Verica Stamenkova Trajkova
Shkup, prill 2026

Titulli origjinal në gjuhën maqedonase: Сценарио за на час: превенција на трговијата со деца од рана училишна возраст (VI одделение)

Ky material edukativ u prodhuan me mbështetjen e financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon “©Këshilli i Evropës, viti i botimit”. Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Departamentit të Publikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Përgjithshme për Demokraci dhe Dinjitet Njerëzor, Avenue de l'Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France, Tel. +33 (0)3 88 41 20 00
E-mail: Horizontal.Facility@coe.int

Fotografia kryesore: Shutterstock
Ilustrime: Sara Prenk

© Këshilli i Evropës, prill 2026. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara

Skenar për orë mësimi: Si të parandalojmë trafikimin me fëmijë të moshës së hershme shkollore (klasa VI)

Shtjellimi i tregimit “*Pinoku*” të Karlo Kolodit – mësim për besimin, rrezikun dhe mbrojtjen nga keqpërdorimi dhe trafikimi me njerëz

Lënda mësimore	Histori dhe shoqëri: në kuadër të Shoqërisë Civile ose orë kujdestarisë
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	Klasa VI
Tema/fusha në programin shkollor	• Mbrojtja e të drejtave të fëmijës • Mbrojtja e të drejtave të njeriut
Numri i orëve	Gjithsej një orë shkollore
Pajisje dhe mjete	• Një version i shkurtuar i tregimit "Pinoku" • Fotografi nga revista/postera • Letër e trashë vizatimit, lapsa me ngjyrë ose ngjyra të tjera • Markera (stilolapsa me shtupë), lapsa me ngjyrë ose ngjyra dylli • Ngjitës/shirit ngjitës, gërshërë • Shënime për mësuesin • Mjete ndihmëse audio-vizuale, të përshtatura sipas moshës(sipas dëshirës)
Qëllimet	Qëllimi i përgjithshëm Të nxitet njohja, ndjeshmëria dhe përgjegjësia te fëmijët nëpërmjet tregimit “Pinoku”, me qëllim që te fëmijët të zhvillohet vetëdija për rreziqet nga manipulimi dhe keqpërdorimi, të kuptojnë rëndësinë e besimit dhe sinqeritetit si dhe të mësojnë si të mbrojnë veten e tyre si dhe të tjerët nga trafikimi me fëmijë si dhe nga keqpërdorimet e tjera. Qëllime të veçanta Nxënësit: • E kuptojnë përmbajtjen dhe porosinë e tregimit <i>Pinoku</i>. • I njohin zgjedhjet (vendimet) e mira dhe të këqija të cilat i bën “<i>Pinoku</i>” - personazhi kryesor. • Mësojnë se si mosbindja dhe naiviteti mund t’i shpien shumë lehtë në rrezik fëmijët. • E identifikojnë rolin e ndërgjegjes si një zë i brendshëm i cili na paralajmëron

	kur diçka nuk është në rregull / kur diçka është e rrezikshme. • Bëjnë lidhjen e porosive të tregimit me shembuj bashkëkohorë: rreziqe interneti, profile të rrejshme, trysni nga bashkëmoshatarët, mashtrim dhe tradhti. • Zhvillojnë vetëdijen se gjithmonë mund t'u drejtohen të rriturve të cilëve ju besojnë (arsimtarit, prindit). • Nxiten për mbështetje të ndërsjellë dhe ndjenja e bashkësisë ndërmjet nxënësve.
Rezultatet e pritura	Nxënësit: • E kuptojnë dallimin midis besimit dhe naivitetit. • Zhvillojnë të menduar kritik – të mos besojë menjëherë gjithçka që dëgjojnë. • Njohin manipulimin, mashtrimin, keqpërdorimin nga shembulli i Pinokut. • Zhvillojnë empati (si të futemi në lëkurën e tjetrit) dhe kuptojnë se si ndjenjat mund të ndihmojnë në zgjedhjen e duhur.
Gjatë orës së mësimi	Nxënësit: • Sqarojnë çka nënkupton besimi, si ndërtohet si dhe si mund të cenohet. • Japin shembuj konkret nga tregimi se si u mashtrua Pinoku, si reagoi dhe çfarë mori si mësim. • Shprehin reagime emocionale – si ndjehen kur dikush i gënjen, kur bën gabim ose kur u falin ndonjë gabim. • Tregojnë njohje për sjelljen e sigurt – si të mbrohem në kontekst real dhe digjital. • Krijojnë një shprehje origjinale kreative – një porosi, vizatim, poezi, letër ose kolazh – përmes së cilës do të paraqesin mësimin e nxjerrë nga tregimi. • Diskutojnë në mënyrë argumentuese, duke shprehur mendimet e tyre me respekt për pikëpamjet e të tjerëve. • Njohin (e dijnë) kur kanë nevojë për mbështetje dhe kur mund ta kërkojnë atë pa frikë.

Metodologjia / teknika të rekomanduara	• Shqyrtimi i mediave audio-vizuale me analizë • Stuhi idesh (brainstorming) • Diskutim hyrës • Punë krijuese (vizatim, kolazh, kompozim/poezi) • Lojë me role • Reflektim individual i nxënësve													
Vlerësimi	<table><tr><th>Fusha</th><th>Treguesit/indikatorët</th></tr><tr><td>Njohje</td><td>Bënë lidhjen e porosive të tregimit me situata reale.</td></tr><tr><td>Ndërgjegjësimi emocional</td><td>I njeh dhe i shpreh ndjenjat e personazheve.</td></tr><tr><td>Kreativitet</td><td>Krijon poezi, vizatime dhe kolazhe me një porosi personal.</td></tr><tr><td>Mendim kritik</td><td>Mendon për atë që është e vërtetë, çfarë është mashtrim.</td></tr><tr><td>Reflektim</td><td>Shpreh çka ka mësuar dhe si do ta zbatojë atë në jetë.</td></tr></table>	Fusha	Treguesit/indikatorët	Njohje	Bënë lidhjen e porosive të tregimit me situata reale.	Ndërgjegjësimi emocional	I njeh dhe i shpreh ndjenjat e personazheve.	Kreativitet	Krijon poezi, vizatime dhe kolazhe me një porosi personal.	Mendim kritik	Mendon për atë që është e vërtetë, çfarë është mashtrim.	Reflektim	Shpreh çka ka mësuar dhe si do ta zbatojë atë në jetë.	
Fusha	Treguesit/indikatorët													
Njohje	Bënë lidhjen e porosive të tregimit me situata reale.													
Ndërgjegjësimi emocional	I njeh dhe i shpreh ndjenjat e personazheve.													
Kreativitet	Krijon poezi, vizatime dhe kolazhe me një porosi personal.													
Mendim kritik	Mendon për atë që është e vërtetë, çfarë është mashtrim.													
Reflektim	Shpreh çka ka mësuar dhe si do ta zbatojë atë në jetë.													
Zbatimi i skenarit	Mësuesi që zhvillon këtë aktivitet vendos në mënyrë të pavarur për përzgjedhjen e aktiviteteve në përputhje me nivelin zhvillimor dhe kontekstin socio-kulturor të nxënësve.													

Aktiviteti "Pinoku dhe Siguria"

Qëllimet:

- Të kuptohet çka nënkupton trafikim me fëmijë
- Të identifikohen teknikat e zakonshme të trafikantëve me fëmijë
- Të zhvillohet vetëdija për siguri
- Të nxitet veprimi proaktiv

Një kujtesë e shkurtër e historisë (5-10 minuta)

Nxënësit e përmbledhin tregimin e Pinokut në 3-4 fjali, për shembull:

"Pinoku është një kukull që dëshiron të bëhet një djalë i vërtetë. Ndonjëherë ai gënjen ose merr vendime të këqija, gjë që e vendos në situata ku të panjohurit përpiqen ta mashtrojnë ose të përfitojnë prej tij. Dhe për fat të mirë, ai po mëson të kërkojë ndihmë dhe të marrë vendime më të mira."

Mësuesi pyet:

- A mund të jepni një shembull kur Pinoku u besonte njerëzve të gabuar?
- Çfarë e bëri atë të cenueshëm? (shembuj: naiviteti i tij, dëshira e tij për t'u pëlqyer të tjerëve, etj.)

Hyrje në trafikimin e fëmijëve (Mësuesi shpjegon) (5 minuta)

Definicioni:

Trafikimi i fëmijëve është kur fëmijët vidhen, u merren prindërve të tyre ose detyrohen të bëjnë gjëra kundër vullnetit të tyre, shpesh për para. Kjo mund të përfshijë punë të detyruar, lypje, kontakt fizik të padëshiruar, vjedhje xhepush e detyruar... Është një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut dhe duhet të ndalet. *Taktikat e zakonshme të përdorura nga trafikantët e fëmijëve:*

- **Mashtim dhe premtime të rreme** – Për shembull: premtim të dhuratave, çokollatë ose të holla.
- **Rrëmbim** – Marrja me forcë e fëmijëve, ftesë për të hytur në makinë dhe ikja me vrap.
- **Manipulim dhe përgatitja e viktimës për manipulim** – Ndërtimi i besimit me kalimin e kohës, bërja e pyetjeve personale, që shpesh ndodh në internet, duke i ndikuar fëmijët që të bëjnë gjëra që i dëmtojnë ata.
- **Shfrytëzim i cenueshmërisë** – Synojnë fëmijët që janë vetëm, në një situatë të vështirë ekonomike, pa kujdesin e të rriturve ose të frikësuar.

Diskutim në klasë – lidhni Pinokun me trafikimin e fëmijëve (5-10 minuta)

Mësuesi e drejton bisedën me pyetjet e mëposhtme:

- Si mund të ishte kapur Pinoku nga trafikantët e qenieve njerëzore/kriminelët?
Shembuj: Të besosh tek të huajt, të shkosh në vende të pasigurta, të kesh frikë t'i tregosh dikujt.

- Cilat ishin cenueshmëritë e tij?
Shembuj: Naiviteti, frikë të pranoj se ka bërë një gabim, dëshirë për të zbarkuar në aventura.
- Çfarë mund të bënte që të mbetej i sigurt?
Shembuj: Të kërkojë ndihmë nga të rriturit të cilëve u beson (Xhepetoja), të telefonojë në linjat e sigurisë, të refuzojë ofertat që duken shumë të mira për të qenë të vërteta, të mos ndajë informacione personale në internet. **(Ndani me nxënësit burime të rëndësishme, të tilla si: tel. i MPB-së 192 / 112; „La Strada“ (Portë e Hapur) linjë telefonike pa pagesë: 0800 11111; Ambasada e Parë e Fëmijëve Megjashi Këshillimore: +38970 390 632; ose redbutton.mvr.gov.mk për denoncim të njohurive ose informacioneve për keqpërdorim ose trafikim me fëmijë.)**

Fëmijët që janë në rrezik mund të ndihmohen dhe të shpëtohen nga njerëzit e këqij!

Udhëzime sigurie (të ndara nga mësuesi/ja):

- Nuk është kurrë faji yt nëse dikush përpiqet të të mashtrojë ose të të lëndojë.
- Gjithmonë duhet t'i tregosh një të rrituri që i beson.
- Ka shërbime dhe linja telefonike pa pagesë të gatshme për t'ju ndihmuar.

Reflektim kreativ (15-20 minuta)

Nxënësit krijojnë dhe shpjegojnë:

- **Poster ose kolazh** – do të shpalosin sjellje të sigurt dhe të pasigurt.
- **Pikturë ose vizatim** – do të ilustrojnë një skenë ku Pinoku kërkon ndihmë ose bën një zgjedhje të sigurt.
- **Dramatizim (luajtje me role)** – Në grupe të vogla, ata luajnë skenat e mëposhtme:
 - Pinoku joshet nga një i huaj.
 - Pinoku kërkon ndihmë nga një i rritur të cilit i beson.
 - Skenar i një telefonate në një linjë pa pagesë, ku Pinoku raporton se dikush u përpoq ta merrte me vete ose ta shfrytëzonte.

Inkurajoni nxënësit të tregojnë guxim, të kërkojnë ndihmë dhe të mos turpërohen të flasin hapur.

Reflektim në një rreth (5 minuta)

- Çdo nxënës ndan një gjë që ka mësuar:

Shembull: "Herën tjetër që ndihem i pasigurt, do të..."

- Mësuesi i shpie nxënësit te përfundimi:

"Pinoku bëri shumë gabime, por gjithmonë mësonte prej tyre. Kështu që edhe ne mund të jemi të kujdesshëm, por edhe të guximshëm, kur dikush përpiqet të na gënjejë. Sot, rreziqet nuk janë vetëm në rrugë – ato janë edhe online. Kjo është arsyeja pse duhet t'i besojmë ndërgjegjes sonë, prindërve tanë dhe njerëzve që na duan."

Materiale shitesë

Doracak për mësues dhe bashkëpunëtorë profesionalë- Mbrojtja e fëmijëve nga trafikimi i qenieve njerëzore: çfarë duhet të bëjnë shkollat? [1680a4368b](#)

Materiale edukative dhe informuese (afishe, libra me ilustrime, video) [Publications about Combatting Human Trafficking- Програмска канцеларија на Советот на Европа во Скопје](#)

Doracak për parandalimin dhe ndërhyrjen në dhunë, abuzim dhe neglizhencë në shkolla [priracnik-nastavnici-print.cdr](#) (e disponueshme vetëm në gjuhën maqedonase)

Plotësim – Lojë me role

I. Qëllimi i përgjithshëm i aktivitetit

Përmes aktrimit, dialogut dhe analizës, nxënësit do të:

- njohin situatat të rrezikshme dhe manipuluese,
- zhvillojnë empatinë dhe të menduarit kritik,
- mësojnë si t'u thonë "jo" ofertave të rrezikshme, dhe
- të marrin vendime të sigurt dhe të moralshme.

II. Kohëzgjatja

15 – 20 minuta

III. Materialet e nevojshme

- Kartela me emrat e personazheve (Pinoku, Bulkthi, Dhelpra, Macja, Xhepetoja, Zana)
- Hapësirë për shfaqje skenike (ose skenë e improvizuar në klasë)

IV. Përgatitja e nxënësve

1. Hyrje (5 minuta):

Mësuesi shpjegon se nëpërmjet lojës ata do ta shqyrtojnë tregimin nga një këndvështrim tjetër.

Pyet:

- "A të ka ofruar ndonjëherë dikush diçka që dukej shumë e mirë për të qenë e vërtetë?"
- "Si e kupton kur dikush po të gënjen ose po përpiket të të shfrytëzojë?"

2. Ndarja e roleve:

Secili grup zgjedh një Pinok, një Bulkth, një Dhelpra, një Macja, një Xhepeto dhe një Zanë. Nëse ka më shumë nxënës, mund të krijohen 3–4 grupe paralele, secili me skenarin e vet.

3. Sqarimi i detyrave:

Arsimtari tregon:

"Do të përshkruani një skenë nga jeta e Pinokut.

Detyra juaj është t'i tregoni se si ai mund të marrë një vendim të mirë ose të keq – dhe çfarë ndodh më pas."

"Nuk ka të bëjë me aktrimin perfekt, por me të menduarit se si ndihet secili personazh."

V. SKENARËT E SUGJERUAR – lojë me role

Tregimi shfrytëzohet në përputhje me qëllimin e synuar të arsimtarit.

Skenari	Përmbajtja	Porosia / Qëllimi
---------	------------	-------------------

1. Pinoku dhe Bulkthi	Pinoku dëshiron të shkojë në ishullin ku nuk ka shkollë dhe të gjithë po argëtohen. Bulkthi e paralajmëron.	Të njihet rëndësia e ndërgjegjes dhe zëri i arsyes.
2. Pinoku dhe shokët e këqij (Dhelpra dhe Macja)	Ata i ofrojnë atij "para të lehta" nëse ai ua jep paratë e tij.	Manipulim, mashtrim, naivitet.
3. Pinoku dhe Xhepetoja	Pinoku kthehet në shtëpi pas atyre gënjeshtreve. Xhepetoja e fal, por kërkon sinqeritet.	Vlera e ndjesës dhe besimit.
4. Pinoku dhe Zana	Zana e inkurajon të thotë të vërtetën, hunda i rritet kur gënjen.	Pasojat e gënjeshtres, ndershmërisë dhe vetëvlerësimit.

VI. SHEMBULL NË SKENË

Skena: "Ishulli i Argëtimit"

Personazhet: Pinoku, Bulkthi, Dhelpra, Macja

Pinoku:

"Dëgjo, Bulkth! Nuk ka shkollë atje, nuk ka rregulla! Vetëm lojëra dhe ëmbëlsira! Do të shkoj edhe unë!"

Bulkthi:

"Por, Pinok, kjo më duket e dyshimtë. Pse dikush do të të ofronte kaq shumë pa asnjë arsye?"

Dhelpra:

"Eh, mos e dëgjo! Ne do të dërgojmë atje. Atje të gjithë janë të lumtur dhe të lirë!"

Macja:

"Do të të tregojmë si të bëhesh i pasur pa mund fare!"

Pinoku:

"Vërtet? Epo, ndoshta duhet të rrezikoj pak..."

(Pinoku shkon me ta. Mësuesi ndërpret skenën.)

Mësuesi:

"Ndalo! Tani le të mendojmë- çfarë do të ndodhë më pas? Cili është rreziku? Si mund të ishte ndryshe?"

VII. DISKUTIMI PAS PARAQITJES SKENIKE (10 minuta)

Mësuesia drejton një bisedë:

- Pse Pinoku i beson Macës dhe Dhelprës? Si e gënjyen?
- Kush tentoi ta ndihmonte? Çfarë përfaqëson Bulkthi?

- Cili është shembull i ngjashëm nga jeta reale?
(ofertë online, profil i rremë, dhuratë falas, kërkesë për të dërguar fotografi, ofertë për të dalë me një "mik" të panjohur)
- Si mund të themi "jo" pa pasur frikë?

Përgjigjet shkruhen në tabelë në dy kolona:

Zgjedhje të sigurt

Zgjedhje të rrezikshme

VIII. REFLEKTIM I SHKURTËR DHE MBYLLJE

1. Secili fëmijë përfundon fjalinë:

- "Mësova se..."
- "Herën tjetër që dikush do të më ofrojë diçka të dyshimtë, unë do të..."

2. Nxënësit mund të shkruajnë një letër të shkurtër për Pinokun:

"I dashur Pinok, po të isha në vendin tënd, do të bëja..."

3. Porosi përmbyllëse nga mësuesi:

"Ndonjëherë të gjithë jemi si Pinoku - kureshtarë dhe naivë.

Por është e rëndësishme të dëgjojmë zërin e ndërgjegjes dhe të dallojmë kur dikush nuk ka qëllime të mira për ne."

Shenjat paralajmëruese të fëmijët

- Ndryshime të papritura në sjellje (tërheqje, frikë).
- Mungesa të shpeshta ose shmangie të shkollës.
- Kërkesa të shpeshta për mungesa nga shkolla për shkak të dhimbjeve të stomakut, etj.
- Rrëfim i tregimeve që sugjerojnë kontakt me të huaj (në jetën reale ose në internet).
- Dhurata, para ose objekte të pashpjegueshme.
- Ankth i dukshëm kur flitet për sigurinë ose besimin.

✦ Këto shenja nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht trafikim të fëmijëve, por ato janë një sinjal se fëmija është në rrezik dhe ka nevojë për vëmendje shtesë.

DHELPRA

Biletë Ishull i ahengut



XHEPETO




MACJA



PINOKU



BULKTHI



ZANA



Ky material edukativ u prodhua me mbështetjen e financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.europa.eu

www.coe.int

SQI

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës